

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KUÇOVË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. Prot. 3747

Kuçovë, më 06/12/2022

**VENDIM**

Nr. 76, dt. 30.11.2022

**Për miratimin e projektit: "Rikonstruksion e shkollës 9-vjeçare "Koço Korçari".**  
Këshilli Bashkiak pasi shqyroi materialin e paraqitur, i cili është në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 dt. 30.07.2018 " Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetë qeverisjes vendore, Buxhetit të Bashkisë Kuçovë për vitin 2022, sipas V.K.B, nr. 85, dt. 23.12.2021, të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë me nr. 3/2 prot., dt. 14.01.2022:

**VENDOSI:**

- 1.1 Të shtohet plani i buxhetit 3,803,402 lekë, kjo shtese vjen si donacion nga fondet e BE.
- 1.2 Të pakësohet plani, për të mbuluar vlerën (supervizim, kolaudim) e financimit nga ana e Bashkisë:

Institucioni	gr-kap-prog	Llog.	Kod proj.	Emërtimi	Vlera/ lekë
124-2124001	00-01110-05	6020000	9999999	Shpenzime operative	100,896

- 1.3 Të miratohet projekti për rikonstruksionin e shkollës 9-vjeçare "Koço Korçari":

Institucioni	Gr-kap-prog	Llogaria	Kod projekti	Emërtimi	Total/lekë
124-2124001	00-05-09120	2310000		Projekti	4,564,082
124-2124001	00-05-09120	2310000		Supervizim	91,966
124-2124001	00-05-09120	2310000		Kolaudim	8,900

- 1.4 Financimi i këtij projekti do të jetë: 3,803,402 lekë, me fondet e donatorit (donatori mbulon vlerën e projektit pa tvsh).
- 1.5 Vlera e tvsh së projektit është miratuar në muajin Korrik në këshillin Bashkiak me vendim nr.38 datë 28.07.2022.  
Bashkia do të paguajë tvsh, kolaudim dhe supervizim.
- 1.6 Të shtohet plani i buxhetit 9,087,000 lekë, kjo shtese vjen si donacion nga Ambasada Japoneze me destinacion blerjen e një automjeti zjarrfikës
- 1.7 Vlera e tvsh do të kryhet nga Bashkia, për këtë pakësohen shpenzimet operative :

Institucioni	gr-kap-prog	Llog.	Kod proj.	Emërtimi	Vlera/ lekë
124-2124001	00-01110-05	6020000	9999999	Shpenzime operative	1,817,400

-Shtohet plani i shpenzimeve për blerje automjeti zjarrfikës:

Institucioni	gr-prog	I.log.	Kod proj.	Emërtimi	Vlera/ lekë
124-2124001	00-03280-05	2310000		Blerje automjeti zjarrfikës	10,904,400

Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike.

Ky vendim u miratua me: 21 vota pro, - vota kundër, - abstenim të pranishëm 21 këshilltare.

**KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK**  
**Migena BULLARI**

